



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VLORË

V E N D I M

Nr. 1, datë 26.01.2012

**“MBI STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE
VARTËSE – VITI 2012”**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 26.01.2012, në mbështetje të:

- Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma ç, neni 2, pika 2, 3, neni 44, gërma e, ë, f,
- VKM Nr.553, datë 11.8.2011 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.1619, datë 2.07.2008, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”.
- VKM Nr.513, datë 01.07.2002 “Për caktimin e strukturës, numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe të komunës”
- Ligji Nr. 9780, date 16.07.2007, “ Për inspektoriatin e ndërtimit”, Neni 18:
dhe në referencë të VKM Nr.474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”

V E N D O S I

- I. Të miratojë strukturën, nivelin e pagave dhe numrin e punonjësve të administratës së Bashkisë Vlorë për vitin 2012 deri në miratimin e strukturës të vitit pasardhës, me numër të përgjithshëm **206 (+12)**, me përbërje si më poshtë (tabela bashkengjitur)

1. Drejtues	1 person
2. Kabineti i Kryetarit	4 persona
3. Këshilli i Bashkise	2
4. Administratori i qytetit	11
5. Drejtorja Juridike	6
6. Njësia e Auditimit të Brendshëm	3
7. Drejtorja e Burimeve Njerëzore	6
8. Drejtorja e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun	7
9. Drejtorja e Financë – Buxhetit dhe Kontabilitetit	32
10. Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore	31
11. Drejtorja e Planifikimit të Territorit	15
12. Drejtorja e Projektimit dhe Urbanizimit	5
13. Drejtorja e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve	16
14. Drejtorja e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik	26
15. Drejtorja e Ndihmës dhe Shërbimit Social	10
16. Njësia e Programim – Zhvillimit	2

17. Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik	9
18. Policia Bashkiake	20
19. Zyra e Gjendjes Civile	(+10)
20. Qendra e Regjistrimit të Biznesit	(+2)

II. Të miratojë strukturën, nivelin e pagave dhe numrin e punonjësve të institucioneve dhe njësave vartëse si më poshtë (tabela bashkëngjitur):

1. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	137
2. Teatri “Petro Marko”	30
3. Qendra e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve	24
4. Klubi Shumësportesh “Flamurtari”	14
5. Qendra e Zhvillimit të PAK	5
6. Shtëpia e Fëmijës	6

III. Të miratojë për 3 (tre) aktorë të estradës me arsim të mesëm (Qytetarë Nderi) kategorinë III-B me pagën mujore 31.000 lekë.

IV. Të miratojë shpërblimin mujor të Këshilltarëve të Këshillit të Bashkisë në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë.

V. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

VI. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 8652, datë 31.07.2000, neni 33, pika 6.

Etjona HOXHA

KRYETARE

